

STATUSI I REKOMANDIMEVE

MBLEDHJA E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

Tiranë, 29 Qershor 2016

REKOMANDIME

- KONTROLLI TATIMOR-THJESHTIMI I PROCEDURAVE
- ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATË- BIZNES
- FALIMENTIMI
- INVESTIME & INCENTIVA
- NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK

I. Kontrolli Tatimor -Thjeshtimi i procedurave

Rekomandimet e KI të përfshira në draft-ligjin “Për Disa Ndryshime në Proçedurat Tatimore”. SHTYLLAT:

Informim & Transparencë

- ✓ Njoftimi paraprak për bizneset subjekte të kontrollit dhe vizitave fiskale
- ✓ Detyrimi i publikimit të legjislacionit në gjuhën angleze
- ✓ DPT do të publikojë normën e interesit që aplikon për kamatëvonesat

Standardizim dhe preçedentët tatimorë

- ✓ DPT duhet të publikojë vendimet teknike dhe opinion për trajtime tatimore që vlejné për të gjitha rastet e ngjashme (*preçedent tatimor*)
- ✓ DPT duhet të publikojë në mënyrë periodike buletinin përmbledhës të vendimeve të gjykatave

Të tjera

- ✓ Procedurat e autorizimit te rikontrollit tatimor më të qarta
- ✓ Shkurtim i afateve dhe lehtësim i proçedurave për ç’regjistrimin e bizneseve
- ✓ Falimentimi i subjekteve debitore sipas parashikimeve të ligjit mbi falimentimin dhe jo me kërkesë të AT.
- ✓ Dogana- “*Sporteli i vetëm doganor*” që do të thjeshtojë procedurat administrative të bizneseve. Informacioni në lidhje me një biznes do të merret nëpërmjet shkëmbimit *on-line* të tij me 20 agjenci qeveritare.

II. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve administratë-biznes

Draft-ligji “Për Disa Ndryshime në Procedurat Tatimore” - rriten garancitë në procedurat e apelimt tatimor.

Ridimensionohet roli i DAT

- ✓ Në varësi të MF
- ✓ Krijohet Bordi për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore
- ✓ Vendimet e DAT dhe Bordit janë përfundimtare dhe të paankimueshme nga administrata tatimore
- ✓ Sqarohet koncepti i barrës së provës në fazën e ankimit tatimor

Ridimensionohet roli i Avokatit të Tatimpaguesit

- ✓ Krijimi në perspektivë i një organi të pavarur të Avokatit të Biznesit

III. Falimentimi

✓ **DRAFT-LIGJI “PËR FALIMENTIMIN”**

ËSHTË MIRATUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE DHE DEPOZITUAR NË KUVENDIN E SHQIPËRISË MË DATË 09.06.2016. NË PROCEDURË NORMALE SHQYRTIMI.

IV. Investime & Incentiva

- ✓ AIDA në bashkëpunim dhe me Departamentin e Investimeve Strategjike (SBIU) pranë Kryeministrisë janë duke përgatitur *'incentives mapping'*.
- ✓ AIDA në proces përgatitje të *'road map'* për investimet në sektorët strategjikë. Këto road maps do të ndihmojnë në terma proceduriale dhe incentivash potenciale çdo lloj kërkesë për çdo propozim për investim që do të paraqitet pranë AIDA.
- ✓ AIDA ka një *Inventar- databazë të mirëfilltë pronash shtetërore*, për t'u vënë në dispozicion të investitorëve strategjikë. Platforma elektronike e këtyre asetëve do të jetë shumë shpejt *on line*, sapo të certifikohen përfundimisht nga të gjitha institucionet të dhënat mbi pronat shtetërore.
- ✓ Puna për strukturimin dhe përditësimin e *web zyrtar* është në proces. Deri në fund të shtatorit AIDA do të administrojë një web zyrtar të ri, web e TEDA ashtu si dhe regjistrin elektronik të investimeve strategjike.

V. Njoftimi dhe konsultimi publik

- ✓ *Draft-ligji “Për Disa Ndryshime në Procedurat Tatimore”* është shpërndarë për diskutim me grupet e interesit, shoqatat e biznesit, biznese, Sekretariatit e KI etj.
- ✓ *Iniciativa pozitive nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin lidhur me zbatimin e Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.* Ministritë do të jenë të detyruara të vendosin në matricën shoqëruese të projekt-akteve që do të miratohen nga Këshilli i Ministrave, veprimet konkrete që kanë bërë për njoftimin dhe konsultimin e akteve me grupet e interesit.

PËRMBLEDHJE	
REKOMANDIME	35
MASA TË PROPOZUARA	60
MASA QË KËRKOJNË NDRYSHIME LIGJORE	16
TË PËRMBUSHURA	4 REKOMANDIME (2 masa ligjore; 2 masa të tjera) dhe disa pjesërisht
DRAFT-LIGJ	10 REKOMANDIME (14 masa ligjore; 5 masa të tjera) dhe disa pjesërisht
NË PROÇES DISKUTIMI DHE VLERËSIMI	13